

Udhëzues për zgjedhjet federale



X
It's Our Vote

Lista për verifikim për zgjedhësin



Sigurohuni që të jeni i regjistruar në adresën e tanishme.



Jini në pritje të kartës suaj të votuesit me postë.



Bëni një plan për të votuar.



Mësoni se cilët janë kandidatët në zonën tuaj elektorale.



Sillni Dokument Identifikimi kur të shkoni të votoni.



Në qendrën tuaj të votimit që ju është caktuar në ditën e zgjedhjeve.



Në qendrën tuaj të votimit që ju është caktuar në ditët e votimit paraprak.



Ne çdo **zyrë të Zgjedhjeve Kanada** në të gjithë Kanadanë (zbatohen afatet)




Me postë: vizitoni **elections.ca** për të marrë më shumë informacion (zbatohen afatet)

Kjo broshurë është e disponueshme në shumë gjuhë të ndryshme në **elections.ca**.
Telefononi për format e tjera si sistemin braj, gërma të mëdha dhe sistemin informativ dixhital..

Zgjedhjet federale do të mbahen këtë vit

Sigurohuni që të regjistrohni për të marrë kartën e informacionit të votuesit.



Në qoftë se jeni i regjistruar, ju do të merrni kartën e informacionit të votuesit me postë, pasi zgjedhjet të shpallen. Ajo ju tregon se ku dhe kur mund të votoni. Silleni me vete këtë kartë së bashku me dokumentin ose dokumentat identifikues të pranueshëm kur të shkoni të votoni për ta bërë procesin e votimit më të lehtë.

Në qoftë se ju nuk merrni një kartë ose të dhënat në kartë janë të gabuara, ju mund të mos jeni i regjistruar ose të dhënat tuaja si votues mund të mos jenë përditësuar. Vizitoni elections.ca ose na telefononi në 1-800-463-6868 për të verifikuar dhe përditësuar regjistrimin tuaj. Ju gjithashtu mund të regjistrohni kur të shkoni të votoni.

Për t'u regjistruar dhe për të votuar në zgjedhjet federale, ju duhet:

- Të jeni qytetar kanadez
- Të jeni të pakten 18 vjeç në ditën e zgjedhjeve
- Të vërtetoni identitetin dhe adresën tuaj

Mënyrat e votimit

Ju mund të votoni pothuajse në çdo kohë gjatë periudhës së zgjedhjeve.
Zgjidhni alternativën e votimit që është më e mirë për ju.

1 Në ditën e votimit

Qendra juaj e votimit do të jetë e hapur për 12 orë (orët në provinca ndryshojnë)

2 Në ditët e votimit paraprak

Qendra e votimit që iu është caktuar do të hapet nga ora 9 e mëngjesit deri në orën 21:00 të premtën, të shtunën, të dielën dhe të hënën në javën para ditës së zgjedhjeve.

3 Në çdo zyrë të Zgjedhjeve Kanadaze në të gjithë Kanadanë

Shkoni në cilëndo zyrë të Zgjedhjeve Kanadeze para të martës para ditës së zgjedhjeve në orën 18:00. Ju do të votoni duke përdorur procesin e veçantë të votimit. Pasi zgjedhjet të jenë thirrur, vizitoni elections.ca ose na telefononi për të gjetur zyrën më të afërt.

4 Me postë

Vizitoni elections.ca ose na telefononi për të marrë më shumë informacion. Zbatohen afatet.

Kontrolloni **kartën tuaj të informacionit të votuesit** për ditët e votimit, vendndodhjet dhe orët tuaja.

Dokumenta Identifikimi për të votuar

Ju keni tre alternativa për të vërtetuar identitetin dhe adresën tuaj.

Alternativa 1



Paraqisni një nga këto dokumenta identifikimi

- Lejen tuaj të drejtimit
- çdo kartë tjetër të lëshuar nga qeveria Kanadeze (federale, provinciale/territoriale ose lokale) me fotografinë, emrin dhe adresën tuaj të tanishme

ose

Alternativa 2



+



Paraqisni dy dokumenta identifikimi

Të dy dokumentat duhet të kenë emrin tuaj dhe njëra duhet të ketë të paktën adresën tuaj të tanishme.

Për shembull:

- karta e informacionit të votuesit dhe deklarata bankare
- fatura e energjisë/ujit/gazit dhe karta e studentit

Nuk i keni këto dokumenta? Mos u shqetësoni!

Ka dokumenta të tjera identifikimi që pranohen.

Shikoni listën e plotë tek elections.ca

ose

Alternativa 3



+



Në qoftë se nuk keni dokument identifikimi

Ju ende mund të votoni nëse deklaroni identitetin dhe adresën tuaj me shkrim dhe keni dikë, i cili ju njih dhe është caktuar në qendrën tuaj të votimit dhe garanton që jeni ju.

Personi garantues duhet të jetë në gjendje të vërtetojë identitetin dhe adresën e tyre.

Një person mund të jetë garantues vetëm për një person (përveç në institucionet e kujdesit afatgjatë).

Aksesueshmëria



Të gjithë zgjedhësve u caktohen qendrat e votimit për ditën e zgjedhjeve dhe ditët e zgjedhjeve paraprake. Pasi zgjedhjet të thirren, sigurohuni që qendra e votimit që iu është caktuar të plotësojë nevojat tuaja për akses:

- duke verifikuar kartën tuaj të informacionit të votuesit;
- duke futur kodin tuaj postar në kutinë e Shërbimit të Informacionit të Zgjedhësit në **elections.ca**; ose
- duke na telefonuar në 1-800-463-6868 ose 1-800-361-8935 (për shurdh-memecët)

Na telefononi nëse keni ndonjë shqetësim rreth hyrjes për në qendrën e votimit që iu është caktuar.

Për të kërkuar ndihmë paraprake në votim, përfshirë interpretimin e gjuhës dhe gjuhën e shenjave, telefononi zyrën e Zgjedhjeve Kanada në zonën tuaj elektorale para orës 18:00 të ditës së martë të ditës së zgjedhjeve.


Mjetet dhe shërbimet ndihmëse për votim në ditën e zgjedhjeve:

Fletë-votimi më e madhe me emrat e kandidatëve me gërma të madha




Zmadhues (4x)

Gërma të mëdha dhe lista e kandidatëve në alfabetin braj



Laps të madh

Model votimi me prekje dhe në alfabetin braj



Ndihmë për të markuar fletën tuaj të votimit

X
It's Our Vote